

STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MAIN STREET SOLUTIONS” SH.P.K.

I. THEMELIMI

Neni 1
Preambula

Shoqëria “MAIN STREET SOLUTIONS” SH.P.K. (referuar përgjatë dokumentit si “Shoqëria”), themelohet nga ortaku themelues:

- **Z. Klajd Gazulli**, shtetas amerikan i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i biri i Filip, lindur në Tiranë, më datë 02.12.1979, identifikuar nga pasaporta me nr.A12946645;

Si një person juridik shqiptar i cili funksionon në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

ATËHERË, themeluesi i Shoqërisë, Z. Klajd Gazulli, ka hartuar dhe miratuar këtë Statut në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në veçanti me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të këtij Ligji, ku rregullohen hollësisht çështjet e organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, kjo në përputhje me ligjin shqiptar dhe çdo legjislacion të mëvonshëm të zbatueshëm.


Neni 2
Ortaku i Vetëm

Ortak i Shoqërisë është Z. Klajd Gazulli, shtetas amerikan i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i biri i Filip, lindur në Tiranë, më datë 02.12.1979, identifikuar nga pasaporta me nr.A12946645 (në vijim referuar si “Ortaku i Vetëm”).

Kontributet e Ortakut të Vetëm në kapitalin e shoqërisë janë në para. Kontributet e Ortakut të Vetëm në para nuk do të jenë më pak se 100 (njëqind) Lekë.

Duke u nisur nga kontributet në para të dhëna në kapital nga Ortaku i Vetëm, Z. Klajd Gazulli zotëron një kuotë që përfaqëson 100% (njëqind për qind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortaku i Vetëm ka derdhur kontributin e tij në kapitalin e Shoqërisë, me qëllim që të përfitojë të ardhura që burojnë nga veprimtaria e Shoqërisë, duke mos u përgjigjur për detyrimet e Shoqërisë, por duke mbuluar personalisht humbjet e Shoqërisë deri në

Klajd Gazulli 

pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Për mënjanimin e çdo dyshimi, Ortaku i Vetëm gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tij në kapitalin e përfaqësuar në pjesë kapitali.

II. EMËRTIMI- SELIA- FORMA LIGJORE- OBJEKTI

Neni 3 Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është shoqëria tregtare *"MAIN STREET SOLUTIONS" SH.P.K.* Emri tregtar i shoqërisë është *"MAIN STREET SOLUTIONS" SH.P.K.*

Neni 4 Selia

Selia e Shoqërisë është në adresën "Rruga e Barrikadave", Qendra Tregtare Galeria, Ndërtesa 9, Zyra 8, nr.pasurie 7/406-N32, ZK 8360, Njësia Administrative nr.9, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me miratim paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.


Neni 5 Forma Ligjore

Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), në përputhje me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6 Baza Ligjore

Shoqëria "MAIN STREET SOLUTIONS" SH.P.K, do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshme në bazë të legjislacionit shqiptar.

Klajd Biazulli 

Neni 7
Emblema dhe Vula

Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Administratori. Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

Neni 8
Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ofrimi i shërbimit të marketingut për palë të treta në fushën e shitjes së produkteve të policave të sigurimit, produkteve të tjera financiare, si dhe të materialeve dhe sistemeve të ndërtimit për rinovime të pasurive të paluajtshme, si p.sh. rinovime dhe rregullime çatiash, etj, duke kontaktuar nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit online, email, fax, ose telefon, etj, klientët potencialë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo në vende të tjera të botës, përfshirë Shqipërinë, me qëllim marketimin e produkteve të ofruara.

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria mund të kryejë, gjithashtu të gjitha veprimet e nevojshme mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Shoqëria mundet gjithashtu të ketë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.


Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, rrjedh apo ka të bëjë me objektivat e renditura sa më lart. Për të arritur qëllimet e mësipërme, Shoqëria mund të ndërmarrë aktivitet tregtar, financiar, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në menyrë që të arrihet dhe përmbushet objekti i Shoqërisë.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të ngushtohet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

III. KOHËZGJATJA

Neni 9
Kohëzgjatja

Klajd Bazulli 

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pakufizuar. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë kufizim kohor në jetëgjatësinë e Shoqërisë.

IV. KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 10

Kapitali

Kapitali fillestar i Shoqërisë është në para.

Ky kapital në para është tërësisht i shlyer nga Ortaku i Vetëm, përpara regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar.

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) Lek, i ndarë në 1 (një) kuotë.

Z. Klajd Gazulli zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100 (njëqind) Lekë, që përfaqëson 100% (njëqind përqind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar në para janë shlyer me para dhe janë paguar plotësisht përpara nënshkrimit nga Ortaku i Vetëm.

Nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve të mëtejshme të kapitalit mund të bëhet me para ose me kontribute në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 11

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me kontratë shkresë private ose me akt noterial.

Pjesët e kapitalit transferohen automatikisht në rrugë trashëgimie.


Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve të Shoqërisë (nëse do ketë më shumë se një ortak), si dhe shoqërive të kontrolluara prej tyre në rast se ka të tilla.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'i transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, kjo vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e pjesëve të kapitalit themeltar (nëse do ketë më shumë se një ortak). Çdo transferim i kapitalit themeltar bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

E drejta e parablerjes

Transferimi për çfarëdo arsye, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër (nëse do ketë më shumë

Klajd Gazulli 

se një ortak), i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomandë (lajmërim marrje), i cili përmban çmimin, blerësin e mundshëm dhe mënyrën e pagesës.

Në rast se ortaku i cili mban të drejtën e parablerjes nuk përgjigjet brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor të lartpërmendur, atëherë konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes së pjeseve të kapitalit që do të tjetërsohen.

Neni 13

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para apo në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Ortakët (nëse do ketë më shumë se një ortak), mund të rrisin pjesën e tyre në kontributin e kapitalit themeltar vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrjen e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit të Shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit i realizuar nga njëri prej ortakëve nuk i detyron ortakët e tjerë të rrisin edhe ata pjesën e tyre (nëse do ketë më shumë se një ortak).

Vendimi i zmadhimit të kapitalit themeltar mund të sjellë edhe riorganizimin e numrit dhe vlerës së secilës pjesë të tij dhe zotërimin e tyre nga ortakët (nëse do ketë më shumë se një ortak).

Rritja e kapitalit themeltar mund të realizohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen si të tillë me vendim unanim të ortakëve në të njëjtën mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme që miraton zmadhimin e kapitalit themeltar.


Neni 14

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet ekskluzivisht me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kapitali themeltar nuk mund të jetë më i vogël sesa minimumi i përcaktuar me ligj (100 {njëqind} Lekë), përndryshe Shoqëria është e detyruar që të ndryshojë formën e saj juridike apo të shpërbëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Zvogëlimi i kapitalit miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrje të ortakëve që përfaqësojnë $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e kapitalit themeltar të Shoqërisë (nëse do ketë më shumë se një ortak). Zvogëlimi i kapitalit do të bëhet në

Klaid Anzulli



përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

V. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- dhe
- Administratori


Neni 15

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortakët e Shoqërisë (nëse do ketë më shumë se një ortak) dhe nga Ortaku i Vetëm.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:

- ndryshimin e Statutit;
- përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- likuidimin e Shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë, duke i përcaktuar edhe kufizime kompetencash;
- emërimin ose shkarkimin likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë ;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Klajd Gaculli 

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë për ushtrimin e të gjitha tagrave të dhëna nga dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në veçanti për mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje që kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87, pika 1, të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të Ortakëve pjesëmarrës (nëse do ketë më shumë se një ortak), të thirrur sipas Nenit 86, pika 1, të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështjet e renditura në Nenin 81 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicën e votave (pesëdhjetë plus një) të Ortakëve të pranishëm me të drejtë vote (Ortakëve pjesëmarrës, nëse do ketë më shumë se një ortak).

Në Shoqërinë me Ortak të Vetëm, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme me Ortak të Vetëm, për çështjet që parashikon neni 87, pika 1, i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" do të njësohen me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e votave të një Asambleje të Përgjithshme me dy ose më shumë ortakë dhe për çështjet që parashikon Neni 81 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" do të njësohen me shumicën e votave të një Asambleje të Përgjithshme me dy ose më shumë ortakë.


Në Shoqërinë me Ortak të Vetëm, të gjithë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme me Ortak të Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: (i) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; (ii) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; (iii) investime; (iv) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Kjo pavlefshmëri nuk mund t'i kundrejtohet të tretëve që kanë fituar të drejta në mirëbesim nga Shoqëria, përveç rastit kur Shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, ose kur provon se, duke u bazuar në rrethanat e veçanta, i treti nuk mund të mos kish patur dijeni për pavlefshmërinë.

Neni 16

Thirrja dhe Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Mënyra e thirrjes, mbledhja dhe regjistrimi i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhen në përputhje me dispozitat e neneve 81, 82 dhe 83 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë orën, datën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë)

Klajd Gazulli 

ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Lajmërimi bëhet nga Administratori i Shoqërisë. Njoftimi do të dërgohet në adresën që rezulton në Librin e Shoqërisë ose sipas adresës së regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas specifikimeve të mësipërme, atëherë Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët bien dakort për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë (nëse do ketë më shumë se një ortak).

Mbledhja e Asamblesë mund të bëhet edhe sipas rregullave procedurale të mbledhjes të miratuara nga vetë Asambleja e Përgjithshme.

Neni 17 Administratori

Shoqëria administrohet nga 1 (një) ose më tepër se 1 (një) Administrator (në rast të shtimit në të ardhmen të numrit të administratorëve), i emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Numri i administratorëve mund të ndryshohet sa herë që Asambleja e Përgjithshme e gjykon të arsyeshme. Administratori mund të jetë i çdo kombësie dhe emërohet për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjet, me të drejtë riemërimi.


Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Klajd Gazulli, shtetas amerikan i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i biri i Filip, lindur në Tiranë, më datë 02.12.1979, identifikuar nga pasaporta me nr.A12946645, me afat mandati 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

Në rast dorëheqjeje, pushimi nga puna apo skualifikimi të ndonjë Administratori, pasardhësi që do të zërë vendin e Administratorit do të zgjidhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, menjëherë pas kësaj ngjarjeje, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë që nëpërmjet një vendimi të marrë me shkrim, të përfundojë para afatit mandatin e njërit ose të gjithë Administratorëve, pa pasur nevojën dhe detyrimin të shtrojë arsye të motivuar për këtë shkarkim.

Pas pranimit të emërimit, Administratorët do të deklarojnë me shkrim që marrëdhënia e tyre me Shoqërinë është ngritur mbi baza besimi. Në këtë kontekst, vendimi për t'i shkarkuar Administratorët me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të pamotivuar, gjykohet si një arsye legjitime për heqjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Shoqëria mund të përfaqësohet nga 1 (një) Administrator edhe në qoftë se do të

Klajd Gazulli 


emërohen më shumë se 1 (një) Administratorë, ose nga të gjithë Administratorët e emëruar.

Administratorit i janë dhënë të gjitha tagrat për të vepruar, me qëllim për të krijuar marrëdhënie me palët e treta për interes të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, përveç kur këto tagra kufizohen në përgjithësi nga ligji dhe përveç atyre të cilat në menyrë të shprehur u përkasin Asamblesë së Përgjithshme me ligj, akte të Shoqërisë, ose kanë një rëndësi të tillë për të cilat miratimi i Asamblesë së Përgjithshme është i domosdoshëm. Këto kufizime tagrash të Administratorit (ëve) i kundrejtohen palëve të treta.

Aktiviteti i përditshëm i Shoqërisë kryhet nga Administratori (Administratorët) duke përfaqësuar apo vepruar në emër të Shoqërisë me palët e treta, institucionet publike apo private, duke hyrë në marrëveshje si dhe duke përfaqësuar Shoqërinë përballë gjykatave të shkallëve të ndryshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Kompetencat e Administratorit (Administratorëve) që përfaqëson/përfaqësojnë Shoqërinë për këtë qëllim përfshijnë:

- Të veprojë dhe nënshkruajë në emër të Shoqërisë, të punësojë apo të shkarkojë punonjësit e Shoqërisë;
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Të përfaqësojë Shoqërinë, sipas marrëveshjeve të ortakëve dhe vendimeve të Asamblesë;
- Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, eventualisht bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Të mbajë një regjistër ku të regjistrohen emri i plotë i ortakëve, emri i Shoqërisë, vendbanimi apo selia e ortakëve, përqindja përkatëse e interesit në kapitalin themeltar të Shoqërisë, transferimi i kuotave apo çdo ndryshim i të dhënave të mësipërme;

Klyvd Gazulli 

- Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në lidhje me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi thelbësore për veprimtarinë e Shoqërisë;
- Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë që e detyron ligji si dhe për marrjen e vendimeve që duhet miratimi i saj;
- Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut, pa ndërhyrë kurrësesi në kompetencat që me ligj apo Statut i janë dhënë Asamblesë së Përgjithshme;
- Të respektojë të gjithë marrëveshjet e ortakëve dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;

Asambleja e Përgjithshme, në rast të shtimit të numrit të Administratorëve, mund të miratojë një vendim për t'u dhënë të gjithë Administratorëve kompetencë të përbashkët përfaqësimi.

Çdo Administrator, në kryerjen e aktiviteteve të tij përkatëse, duhet të jetë në konformitet me ligjin, rregullat e drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe procedurave për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Administrator do të drejtojë aktivitetin e Shoqërisë dhe do të sigurojë zbatimin e të gjithë urdhrave dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.


Çdo Administrator do të kryejë edhe detyra të tjera siç mund të parashtrohen nga Asambleja e Përgjithshme, dhe gjatë drejtimit normal të aktivitetit, mund të delegojë një pjesë të kompetencave dhe të të drejtave të tij përkatëse tek një ose disa zyrtarë të Shoqërisë, në përputhje me rregullat e procedurës së drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe me procedurën për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Aktet dhe masat që tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të aktivitetit të Shoqërisë janë objekt i miratimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori (Administratorët) është/janë përgjegjës përkundrejt Shoqërisë dhe çdo personi të tretë për çdo shkelje të ligjit apo akteve të Shoqërisë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Shoqëri, siç parashikohet në dispozitat e Nenit 98 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Administratori mban individualisht përgjegjësi përballë Shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e mundshme të ligjit dhe/ose të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, votë e marrë kjo me shumicë të zakonshme. Administratori mund të

Klajd Gazulli 

zëvendësohet në çdo moment me vendim të autoriteteve gjyqësore shqiptare për shkelje të ligjit.

Paga e Administratorit si dhe shpërblime të tjera përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme.

VI. VITI FINANCIAR-LIKUIDIMI

Neni 18

Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më datë 1 Janar dhe duke mbaruar më datë 31 Dhjetor.

Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë pranë organeve tatimore dhe përfundon më datë 31 Dhjetor.

Neni 19

Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

Administratori do të mbajë llogari financiare të përshtatshme dhe do të përgatisë raporte financiare për të pasqyruar me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë, në përputhje me parimet e kontabilitetit. Llogaritë dhe raportet financiare do të jenë në formë dhe përmbajtje në përputhje me standartet e kontabilitetit, sipas parashikimeve ligjore.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën Shqipe dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë.

Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore.


Shoqëria mund të marrë financime nga Ortakët (nëse do ketë më shumë se një ortak) ose nga Ortaku i Vetëm, nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim Shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 20

Ekspertët kontabël të autorizuar

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë të paktën një ekspert kontabël të jashtëm të pavarur, i cili do të jetë një ekspert kontabël i autorizuar (në vijim referuar si "Eksperti Kontabël i Autorizuar"). Eksperti Kontabël i Autorizuar do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të kontrollojë llogaritë e Shoqërisë, regjistrimet e veprimeve dhe

Klaid Gazulli 

transaksioneve të saj;

- Të vërtetojë, në përputhje me rregulloret përkatëse, raportin vjetor mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë (bilancin, pasqyrat financiare të humbjeve dhe fitimeve dhe raporte të tjera që lidhen me to) dhe të japë mendimin e tij nëse pasqyrat financiare pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë;
- Të informojë Administratorin(ët) dhe Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë për çdo parregullsi apo mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve apo llogarive të Shoqërisë të cilat mund të rezultojnë në humbje të konsiderueshme për Shoqërinë;
- Të rishikojë përshtatshmërinë e praktikave dhe procedurave të auditimeve dhe kontroleve të brendshme dhe, nëse është me vend, të japë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Të kryejë të gjitha detyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" siç mund të ndryshojë kohë pas kohe.

Neni 21

Të ardhurat. Dividendi

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve dhe tarifave që i cakton vetë Shoqëria.

Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë, pas pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera të privileguara, mund t'i shpërndahen Ortakëve (nëse do ketë më shumë se një ortak) ose mund t'i shpërndahen Ortakut të Vetëm. Shpërndarja e fitimeve (dividendit) do të bëhet në raport me përqindjen e kuotës që Ortakët (nëse do ketë më shumë se një ortak) zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë.


Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur ose shtuar shumat respektive të humbjeve apo fitimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Humbjet e Shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo Ortak (nëse do ketë më shumë se një ortak) ose Ortaku i Vetëm, do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Neni 22

Shkaqet e prishjes së Shoqërisë

Shoqëria prishet :

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është

Klajd Gazulli 

- njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
me vendim të gjykatës.

Neni 23 **Likuidimi**

Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të prishë Shoqërinë si dhe për çdo shkak tjetër të përcaktuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Në mënyrë që të ndërmarrë procedurat e likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator ose një grup likuidatorësh. Nëse ky vendim nuk do të merret, atëherë çdo person i interesuar, brenda 30 ditëve pas prishjes, mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidator.

Në rastet kur Shoqëria priset me vendim gjykate, likuidatori emërohet nga gjykata.

Administratori njofton për rregjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të dhënat e likuidatorit.

Detyra e likuidatorit është mbyllja e të gjithë veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të Shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferimit në përputhje me Kodin Civil. Likuidatori do të raportojë mbi gjendjen e zërave të aktivitetit dhe të pasivitetit të Shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Përgjithshme shqyrton bilancin përfundimtar të përgatitur nga likuidatori dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.


Në fund të procedurës së likuidimit dhe në rast se të gjithë kreditorët e Shoqërisë janë paguar dhe kështu Shoqëria i ka shlyer të gjithë detyrimet, kapitali i mbetur i kthehet Ortakëve (nëse do ketë më shumë se një ortak) ose Ortakut të Vetëm, kjo në përputhje me pjesët e zotëruara në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 24 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin përgjatë veprimtarisë së Shoqërisë, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 25 **Ligji i Zbatueshëm**

Të gjitha çështjet që nuk trajtohen nga ky Statut në mënyrë të veçantë, do të trajtohen dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për

Klajd Bazzilli 

tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 26
Pavlefshmëria

Në rast se ndonjë nga dispozitat e këtij Statuti do të jetë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, atëherë dispozita në fjalë nuk do të konsiderohet juridikisht, ndërkohë që të gjitha dispozitat dhe nenet e tjerë të këtij Statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshëm.

Neni 27
Dispozita Përfundimtare

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë pasi është nënshkruar nga Ortaku i Vetëm.


Ky Statut hartohet në 1 (një) kopje në gjuhën Shqipe, secila me të njëjtën vlerë juridike.

Ky Statut nënshkruhet sot në Tiranë, më datë 22.08.2023.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
“MAIN STREET SOLUTIONS” SH.P.K

ORTAKU

Z. Klajd GAZULLI



Klajd Gazulli 